


Në pajtim me nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (GZ, Nr. 28, 04.06.2008), Nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 (GZ, Nr. 28, 03.06.2008) dhe në zbatim të Nenit 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare – Shpenzimi i parave publike Nr.01/2013-MF (GZ, 28.05.2013) si dhe neni 25 pika 1. të Statutit të Komunës së Deçanit nr.01-19 të datës 01.06.2010, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.07.2016, miratoi këtë:



RR E G U L L O R E PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë organizatës buxhetore ta bëjë një pagesë nga kategoria e subvencioneve personave fizik dhe juridik.

Neni 2 Fushëveprimi

Me këtë Rregullore, përcaktohet fushëveprimtaria për ndarjen e subvencioneve nga Komuna.

Neni 3 Përkufizimet

1. Përveç përkufizimeve të përcaktuara me ligjet tjera përkatëse, përkufizimet e cekura më poshtë e kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Subvencionet** - përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në llogarinë rrjedhëse, ndërsa transferet janë pagesa të njëanshme, jo të kthyeshme për qeveritë tjera, institucionet joprofitabile, familjet dhe individët.
 - 1.2. **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën.
 - 1.3. **Perfituesit** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e komunës.
 - 1.4. **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton, vepron në komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
 - 1.5. **Komision** nënkupton komisionin e emëruar nga Kryetari i Komunës për vlerësimin e kërkesave të parashtruara për subvencionim.

Kapitulli II

Parimet e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve

Neni 4.

Limitet buxhetore

Komuna ndan subvencione duke u bazuar në Ligjin e miratuar të buxhetit për vitin fiskal.

Neni 5

Vendimmarrja

1. Kryetari i Komunës, merr vendim lidhur me kërkesën e personit fizik apo juridik deri në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona fizik deri në shumën prej-1000,00 €.
3. Kryetari i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona juridik deri në shumën prej-2000,00 €.
4. KPF - sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona fizik dhe juridik në shumën deri në 5000,00 €.
5. Kuvendi i Komunës sipas paragrafit 1 të këtij neni, lejon ndarjen e subvencioneve për persona fizik dhe juridik mbi shumën prej 5000,00-€.

Neni 6

1. Kuvendi i Komunës planifikon shumën totale të subvencioneve e cila duhet të miratohet në kuadër të buxhetit për çdo vit fiskal, poashtu përcakton edhe përqindjen e buxhetit të planifikuar për subvencion me të cilën do të përkrahet çdo fushë veç e veç.
 - 1.1.Subvencionimi në fushën e arsimit..... 20% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.2.Subvencionet për shëndetësi..... 10% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.3.Subvencionet për Kulturë..... 10% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.4.Subvencionet për Rini..... 10% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.5.Subvencionet për Sport..... 30% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.6.Subvencionet për Barazi gjinore..... 10% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.
 - 1.7.Subvencionet për raste Emergjente dhe të jashtëzakonshme 10% e shumës totale të subvencioneve të vitit fiskal.

Neni 7.

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jorezident të Komunës.
2. Personi fizik apo juridik vetëm një here në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve të ndara nga Komuna.

Neni 8

Komisioni, përbërja dhe detyrat

1. Kryetari i Komunës emëron komisionin për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve në përbërje të përfaqësuesve nga fushat specifike.
2. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 5 antarëve, një nga anëtarët e komisionit vlerësues duhet të jetë zyrtar i financave.
3. Komisioni është kompetent për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 30 ditësh.
4. Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione do të refuzohen nga Kryetari me propozim të Komisionit.
5. Komisioni për ndarjen e subvencioneve vepron në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe konform autorizimeve, që ipen nga Kryetari i Komunës.

Neni 9

Marrëveshja për subvencionim

1. Marrëveshja është akt normativ me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e njërës palë ndaj tjetrës.
2. Marrëveshja nënshkruhet nga përfituesii subvencioneve dhe Kryetari i Komunes.
3. Përfituesit e ndihmave shëndetësore bëjnë përjashtim nga zbatimi i paragrafit 2 të këtij Neni.
 - Marrëveshja me persona fizik
 - Marrëveshja me persona juridik

Kapitulli III

Fushat e subvencionimit

Nënkapitulli I

Subvencionet për arsim

Neni 10

1. Subvencionimi në fushën e arsimit:
 - 1.1 Bursa
 - 1.1.1 Për studentë
 - 1.1.2 Për nxënës
 - 1.1.3 Për nxënës me nevoja të veçanta
 - 1.2 Për shkollim deficitar
 - 1.3 Për aktivitete jashtëmësimore (kuize, gara, vizita etj.)

2. Kriteret për ndarjen e bursave përcaktohen nga Drejtoria për Arsim, për profilet e shkollave, fakulteteve dhe shkollave speciale, numrin e bursave dhe lartësinë e vlerës së bursës.
3. Dhënia e bursave realizohet përmes procedurës së shpalljes publike - konkursit për dhënie të bursave. Këto kritere do të realizohen përmes procedurës për ndarjen e bursës.
4. Drejtoria përgjegjëse për Arsim e parashtron propozimin te Kryetari i Komunës për miratimin e propozimit për ndarje të bursave sipas profileve të caktuara.

Kriteret për ndarjen e bursave

Kriteret për ndarjen e bursave janë si në vijim:

- Nota mesatare prej 9-10 ose suksesi i shkëlqyeshëm – 20 pikë,
- Nota mesatare prej 8-9 ose suksesi shumë mirë – 15 pikë,
- Nota mesatare prej 7-8 ose suksesi mirë – 10 pikë,
- Fëmijët pa prind, fëmijët e dëshmoreve, martireve dhe invalidëve të luftës – 25 pikë
- Përsosnat me aftësi të kufizuar 15 pikë
- Rastet me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale 15 pikë

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Vertetimi për regjistrimin në fakultete, shkolla apo shkolla speciale
- Certifikaten e notave
- Vërtetimin për raste sociale
- Certifikaten e gjendjes ekonomike dhe familjare
- Dëshminë që nuk është përfitues i bursës universitare

○ Kushtet e përgjithshme të përfituesit

1. Çdo parashtrues i kërkesës duhet të posedoj keto dokumente;

- 1.1 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.2 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.3 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.4 Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
- 1.5 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

○ Subvencionet për shëndetësi

Komuna ndanë subvencione për qytetarët rezident për përballimin e shpenzimeve të shërimit sipas kritereve të përcaktuara për shëndetësi

▪ Kriteret

- Gjendja e vështirë ekonomike
- Diagnoza
- Numri i anëtarëve të familjes
- Të jetë qytetar rezident
- Mos të jetë përfitues i ndonjë skeme tjetër
- Dëshmi e shpenzimeve mjekësore

○ Kushtet e përgjithshme të përfituesit

2. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente;

- 1.6 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.7 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.8 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.9 Raportingamjeku specialist;
- 1.10 Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;

○ Subvencionet për kulturë

▪ Kushtet

Fushat e subvencionimit nga fusha e kulturës mund të jenë:

- Projektet për organizimin e festivaleve muzikore, të teatrit, të filmit dhe festivaleve tjera,
- Projektet për organizimin e koncerteve të ndryshme artistike,
- Projektet për organizimin e simpoziumeve të ndryshme kulturore,
- Projektet për organizimin e ekspozitave dhe panairove të ndryshme kulturore.
- Për botimin dhe promovimin e librave,
- Shënimin e ngjarjeve të datave historike ,
- Subvencionimine OJQ-ve që promovojnë kulturën,
- Subvencionimii projekteve të personave me aftësi të kufizuara në lëmin e kulturës,

○ Kushtet e përgjithshme të përfituesit

3. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente:

- 1.11 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.12 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.13 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.14 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 1.15 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

- Subvencionet për rini
 - Kushtet

Komuna i subvencionon Projektet dhe aktivitetet të cilat ndërlidhen me avancimin e vlerave për fuqizimin e aktiviteteve rinore

- Kushtet e përgjithshme të përfituesit

4. Çdo parashtrues i kërkesës duhet ti posedoj këto dokumente;

- 1.16 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.17 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.18 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.19 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 1.20 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

- Subvencionet për sport
 - Kushtet

Projektet nga lëmi i sportit subvencionohen për këto aktivitete

- Përkrahja financiare e klubeve sportive të Komunës përmes subvencionimit të kuotizimit në federatat përkatëse për pjesëmarrje në gara,
- Subvencionimin e kërkesave të klubeve apo sportistëve që garojnë si individë, për pjesëmarrje në gara kombëtare dhe ndërkombëtare,
- Subvencionimii projekteve të personave me aftësi të kufizuara në lëmin e sportit

- Kriteret

- Kushtet e përgjithshme të përfituesit

5. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente:

- 1.21 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.22 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.23 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.24 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit bashkangjitur dokumentet e federatës përkatëse të sportit në të cilën garon);
- 1.25 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

- Subvencionet për barazi gjinore
 - Kushtet
 - Kriteret

○ Kushtet e përgjithshme të përfituesit

6. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente:

- 1.26 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.27 Certifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të
- 1.28 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.29 Projekt-propozimi (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
- 1.30 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

○ Subvencionet për rastet emergjente dhe të jashtëzakonshme

Kuptimi i termit “nevojat e jashtëzakonshme” sipas dispozitave të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale, në funksion të zbatimit të Udhëzimit Administrativ, definohet si nevojë momentale, e njëhershme, e jashtëzakonshme dhe jo e vazhdueshme, e cila ju sigurohet familjeve dhe individëve për shpenzimet e varrimit të anëtarit të familjes, për strehim apo ushqim me rastin e vërshimeve apo tërmetit, për sigurimin e lëndëve djegëse për ngrohje, për humbje të dokumentacionit me paratë e fundit, dhe nevoja të tjera të jashtëzakonshme të cilat janë të domosdoshme me rastin e fatkeqësive të ndryshme.

Kushtet dhe kriteret për përfitim nga skema e nevojave të jashtëzakonshme:

- Fatkeqësitë natyrore – vërshime, zjarri dhe tërmete;
- Fatkeqësitë nga aksidentet tjera;
- Vdekja e anëtarit të familjes – shpenzimet për ceremoni varrimi;

Kushtet e përgjithshme të përfituesit

7. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente:

- 1.31 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
- 1.32 Certifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
- 1.33 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
- 1.34 Raportin gjatë kohës, specialistit;
- 1.35 Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar;
- 1.36 Të gjith aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.
- 1.37 Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare, dhe
- 1.38 Dëshmia certifikata e vdekjes për shpenzimet e varrimit në shumën e caktuar nga kuvendi prej 200.00 €, që vlenë për të gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit. Të gjithë personat e interesuar për shfrytëzimin e kësaj të drejte nuk duhet të kalojnë periudhën kohore prej 30 ditëve, duke llogaritur nga data e vdekjes së personit.

Neni 11

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

- 1. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim.
- 2. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta etj).
- 3. Periudha kohore e raportimit duhet të jetë brenda 30 ditëve pas përfundimit të projektit.

4. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas përfitimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ, i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë realizimit të projektit.

Neni 12

1. Komuna mund të inicojë auditimin e personit fizik apo juridik mbi mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga Komuna në formë të subvencioneve.
2. Të gjithë përfituesit të cilët nuk i zbatojnë nenet paraprahe nuk kanë të drejtë të aplikimit për përfitim të subvencioneve dhe iu ndalohet që për 3 (tre) vitet e ardhshme të mos jenë përfitues nga të gjitha kategoritë e subvencioneve të ndara nga Komuna.

Neni 13

Subvencionet për Bujqësi, Bletari, Pemtari

1. Kuvendi i Komunës do të planifikon në buxhetin e çdo viti fiskal edhe një shume të caktuar të mjeteve për subvencionim të bujqësisë, bletaris dhe pemtaris.
2. Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për BPZHR do të zhvillojë të gjitha procedurat e përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve të kësaj fushe.
3. Përfitues të këtyre subvencioneve nuk mund të jenë personat fizik ose juridik të cilët përfitojnë nga subvencionet e nivelit qendror.

Kriteret për ndarjen e subvencioneve për bujqësi, bletari dhe pemtari, përcaktohen nga Drejtoria për BPZHR.

o Kushtet e përgjithshme të përfituesit

8. Çdo parashtrues i kërkesës duhet t'i posedoj këto dokumente:
 - 1.39 Dokument identifikues i Republikës së Kosovës;
 - 1.40 Çertifikatën e regjistrimit për bizneset dhe OJQ-të;
 - 1.41 Numri i llogarisë bankare për të gjithë përfituesit;
 - 1.42 Projekt-propozim (në projekt propozim duhet të përshkruhet aktiviteti me agjendën e planifikuar si dhe specifikimi i projektit);
 - 1.43 Të gjithë aplikuesit për subvencionim duhet të sjellin dëshmi lidhur me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës me përjashtim për ndihmat në shëndetësi.

Kapitulli IV

Transparenca në ndarjen e subvencioneve

Neni 14

Publikimi i përfituesve dhe shumave

1. Drejtoria përkatëse është e obliguar që të bëjë publikimin e listës së përfituesve, duke përfshirë edhe shumat që iu janë ndarë.
2. Publikimi bëhet në ueb-faqen e komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

Kapitulli V
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 15

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me dispozitat e ligjeve dhe akteve nenligjore të miratuara nga institucionet qendrore aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë përkatëse të financave dhe drejtorive tjera përkatëse.

Neni 16

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj rregulloreje bëhen sipas procedurës së miratimit.

Neni 17

Publikimi i Rregullores

Kjo rregullore hyn në fuqi pasi të publikohet në gazetën zyrtare dhe ueb-faqen e komunës dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria përkatëse.

01.Nr.VIII-3

Deçan,dt.29.07.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj